

## SKEDË INFORMATIVE

**Mundësi për aplikim të bashkive në thirrjen “National data protection authorities on reaching out to stakeholders in data protection legislation (CERV-2026-DATA)”.**

### **Synimi i Thirrjes:**

Synimi i kësaj thirrje është të mbështeten më tej aktivitetet e autoriteteve kombëtare për mbrojtjen e të dhënave, për të ndihmuar bizneset e vogla dhe të mesme (SME), ndërmarrjet e mesme në rritje dhe organizatat e ngjashme që të zbatojnë më lehtë detyrimet e GDPR-së.

### **Fushat e veprimit të thirrjes:**

Duke u bazuar në përvojën e fituar nga thirrjet për propozime të viteve 2017, 2019, 2020, 2021 dhe 2024, si dhe në funksion të zbatimit të përfundimeve të raportit të vitit 2024 mbi zbatimin e GDPR-së, agjendës së gjerë të Komisionit për zbatim dhe thjeshtim, si dhe Strategjisë së Data Union, veprimet në kuadër të këtij prioriteti synojnë të mbështesin më tej aktivitetet e autoriteteve kombëtare për mbrojtjen e të dhënave në shtetet anëtare.

Këto aktivitete kanë për qëllim lehtësimin e zbatimit të detyrimeve të GDPR-së nga ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (SME), ndërmarrjet e mesme në rritje dhe organizatat me një numër të ngjashëm punonjësish.

### **Kush mund të aplikojë dhe çfarë konsorciumi pranohet:**

Aplikuesit duhet të jenë bashki nga vendet e BE-së ose vendet e lidhura me programin CERV, ku bën pjesë edhe Shqipëria.

**Aplikanti kryesor (Koordinatori)** duhet të jetë një Autoritet Kombëtar për Mbrojtjen e të Dhënave, sipas nenit 51 të Rregullores (BE) 2016/679 (GDPR), dhe lejohet vetëm një aplikim për çdo shtet anëtar.

### **Bashkë-aplikantët (nëse ka) duhet të:**

- jenë persona juridikë (entitete publike ose private);
- të jenë të themeluar në një nga vendet e pranueshme, përkatësisht:
  - Shtetet Anëtare të BE-së (përfshirë vendet dhe territoret përtej detit – OCT);
  - vendet jo anëtare të BE-së (sipas kushteve të programit).

## Aktivitetet të pranueshme:

Kjo pjesë fokusohet në mënyrën se si autoritetet kombëtare për mbrojtjen e të dhënave duhet të mbështeten për të arritur bizneset dhe organizatat:

- **Mbështetje për zbatimin e GDPR-së:**  
Përmes udhëzimeve praktike, modeleve (template) dhe mjeteve digjitale që mund të përdoren edhe në vende të tjera të BE-së.
- **Rritja e ndërgjegjësimit dhe pajtueshmërisë:**  
Duke promovuar kode sjelljeje dhe certifikime (si “Data Protection Seals”) për të ndihmuar organizatat të respektojnë GDPR-në në mënyrë të unifikuar në BE/EEA.
- **Qasje me perspektivë gjinore:**  
Aktivitetet duhet të jenë gjithëpërfshirëse dhe të shmangin diskriminimin gjinor, duke përfshirë:
  - përdorimin e gjuhës gjithëpërfshirëse,
  - mbledhjen dhe analizën e të dhënave sipas gjinisë,
  - inkurajimin e të gjithë personave për të ushtruar të drejtat e tyre mbi të dhënat.
- **Përfshirje dhe akses i gjerë:**  
Rezultatet e projekteve duhet të jenë lehtësisht të aksesueshme dhe të shpërndahen gjësisht për të gjithë shoqërinë, përfshirë minoritetet dhe personat me aftësi të kufizuara.  
  
Projektet e suksesshme duhet të sigurojnë akses të lehtë dhe shpërndarje të gjerë të rezultateve të tyre për të gjitha grupet e shoqërisë, përfshirë minoritetet dhe në mënyrë të veçantë personat me aftësi të kufizuara.

## Përiudha e zbatimit të projekteve

Projektet duhet të zhvillohen brenda periudhës nga 12 deri në 24 muaj (zgjatja e periudhës së zbatimit të projekteve janë të mundshme, nëse janë të justifikueshme).

## Cili është buxheti i thirrjes për secilën bashki:

Buxheti minimal për një projekt është 75,000 EUR deri në 250,000 EUR. Thirrja ka një buxhet të përgjithshëm prej 2,300,000 milionë EUR, të cilat do të shpërndahen bazuar në projektet e miratuara.

## Si bëhet aplikimi:

Dorëzimi i propozimit bëhet në 3 pjesë:

### Pjesa A

Përfshin informacionin administrativ mbi organizatat aplikuese (koordinatori i ardhshëm, përfituesit, entitetet e lidhura dhe partnerët e asociuar), si dhe buxhetin e përmbledhur të projektit. Plotësohet drejtpërdrejt online.

**Pjesa B – Përshkrimi i veprimit**

Mbulojnë përmbajtjen teknike të propozimit. Duhet të shkarkohet modeli i detyrueshëm në Word nga Sistemi i Dorëzimit, të plotësohet dhe të ngarkohet si dokument PDF.

**Pjesa C** - përmban të dhëna shtesë mbi projektin dhe kontributin e tij në treguesit kryesorë të performancës (KPI) të programit të BE-së. Plotësohet drejtpërdrejt online.

**Kur është afati i fundit:**

Afati i fundit për aplikim është më **28 Maj 2026, ora 17:00 (ora e Brukselit)**.

**Linku i Thirrjes:**

<https://ec.europa.eu/info/funding-tenders/opportunities/portal/screen/opportunities/topic-details/CERV-2026-DATA?isExactMatch=true&status=31094502&frameworkProgramme=43251589&order=DESC&pageNumber=1&pageSize=50&sortBy=startDate>